



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 74 , datë 22.06.2012

MBI

DETYRIMIN PËR FINANCIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2012

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 3 dhe 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe nenit 124 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit, me Vendimin nr. 1, datë 18.01.2012, ka vendosur miratimin e propozimit të B.SH.S, për shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit për vitin 2012, në vlerën totale 150,000,000 lekë. Sipas këtij vendimi (pika 2 dhe 3) përcaktohet se ky fond duhet të derdhet me këste të barabarta tremujore, brenda muajit të parë të çdo tremujori, si dhe B.SH.S brenda muajit prill 2012, duhet të depozitojë propozim për rillogaritje të Fondit të Kompensimit për vitin 2012. Deri në këtë datë, B.SH.S, nuk ka depozituar ende një propozim për rillogaritje të Fondit të Kompensimit për vitin 2012.

Situata e detajuar deri më datë 11.06.2012, në lidhje me detyrimet për pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit dhe detyrimin për kontributin e paderdhur të vitit 2012, rezulton si më poshtë:

- Dëme të paguara nga fondi kompensimit	52,949,277 lekë.
- Detyrimi i paderdhur i kontributit për vitin 2012	22,641,841 lekë.
- Dëme të miratuara të papaguara	353,821,726 lekë.

Siç paraqitet, kontributi i Fondit të Kompensimit për vitin 2012, është i pamjaftueshëm për pagesën e dëmeve objekt i këtij fondi.

Në këto kushte shoqëritë duhet të derdhin gjithë detyrimin e Fondit të Kompensimit të parashikuar për vitin 2012, si dhe B.SH.S të propozojë kontribute shtesë, për të siguruar pagesën e dëmeve sipas parashikimeve të neneve 21, 29, 30 dhe 31 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Të shfuqizohet pika 2 e Vendimit të Autoritetit nr. 1, datë 18.01.2012, “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2012”.

2. Shoqëritë e sigurimit Sigal sh.a., Intersig sh.a., Atlantik sh.a., Albsig sh.a. dhe Eurosig sh.a. të financojnë brenda datës 13 korrik 2012, shumën e kontributeve të fondit të kompensimit për vitin 2012.
3. BSHS, bazuar në germën b), pika 3 të nenit 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, brenda datës 13 korrik 2012, duhet të depozitojë në Autoritet propozimin për rillogaritje fondit të kompensimit shtesë për vitin 2012 duke marrë për bazë vlerat reale për primet bruto, raportin dëme-prime, rimbursimin e dëmeve të paguara nga ky fond për mjete të siguruara, si dhe numrin e mjeteve të pasiguruara.
4. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI